REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr i vendimit - 8958 - -

8958

# V E N D I M

(MBI REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK)

Sot me date 16.02 1995, une gjyqtarje e Gjykates se Rrethit Tirane Morgana Dedi pasi studiova kerkesen dhe dokumentet e tjere te kerkuesve Pajtim Merko, Neshet Zemlaku dhe Lemce Begaj per regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "KLOMER":

## K O N S T A T O V A

Se kerkesa e paraqitur nga kerkuesit Pajtim Merko, Lemce Begaj Neshet Zemlaku, per te regjistruar si person juridik shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "KLOMER" me ortake Z.Pajtim Merko, Lemce Begaj, Neshet Zemlaku, me administrator te vetem Z.Pajtim Merko, me kohezgjatje pa afat dhe mbi 10 vjet, me seli ne Pluk-Lushnje, me kapital themeltar 100.000lek, me objekt veprimtarie:
projektim dhe zbatim rilevime topografike, zbatim punime dheu, murature, betoni, b/arme e zakonshme, punime shembjesh, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, dhe kompletimi i tyre me instalimet e nevojshme, punime restaurimi, punime te shtresave te rrugeve, ujesjellsa, kanalizime, impiante vadites, punmie te mbrojtjes se sistemeve hidraulike, kullimi, ujitje e tokave, eshte e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

## P E R K E T O A R S Y E

ne veshtrim te ligjit nr7638 date 19.11.1992 dhe ligjit nr 7667 date 28.01.1993

## V E N D O S A

Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "KLOMER". Shoqeria tregetare "KLOMER" ka per ortake

///

Z.Pajtim Merko,Neshet Zemlaku,Lamce Begaj,me administrator

Z.Pajtim Merko,me seli ne Pluk-Lushnje,me kapital themeltar

100.000lek,me kohezgjatje pa afat dhe mbi 10 vjet,me objekt veprimtarie:projektim dhe zbatim rilevime topografike,zbatim punime dheu

murature,betoni,b/arme e zakonshme,punime shembjesh,ndertime civile,

industriale,turistike,bujqesore dhe kompletimi i tyre me instalimet e

nevojshme,punime restaurimi,punime te shtresave te rrugeve,ujesjellës

kanalizime,impiante vadites,punime te mbrojtjes se sistemeve

hidraulike,kullimi,ujitje e tokave.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim.

Tirane me date 16.02.1995

G J Y Q T A R E

( Marjana Dedi )

[signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 8958/1 i vendimit

# VENDIM
# I GJYQTARES SE VETME

Sot me date 27-04-05 une ____________, me detyren e gjyqtares ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Administratori i shoqerise tregetare "KLOMER" sh.p.k, z. Pajtim Merkaj, per depozitimin prane rregjistrit tregetar te vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise, te marre ne daten 21.04.2005, ne te cilin eshte vendosur per miratimin e shitblerjeve se pjeseve te kapitalit themeltar brenda ortakeve te shoqerise,

## KONSTATOVA

Se me vendimin Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, nr.8958, date 16.02.1995, eshte rregjistruar si person juridik shoqeria tregetare "KLOMER" sh.p.k.
Me vendim nr.ska, date 21.04.2005 te Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise eshte vendosur:

1. Te miratoje kalimin e te drejtes se pronesise te pjeseve te kapitalit themeltar, te ortakeve, z. Neshet Zemlaku i cili zoteronte 30 % te kapitalit themeltar dhe z. Lamçe Begaj qe zoterontre 30 % te kapitalit themeltar, ne zoterim te ortakut z.Pajtim Merkaj.
2. Te miratoje largimin nga shoqeria te ortakeve Neshet Zemlaku dhe Lamçe Begaj.
3. Ortaku i vetem i shoqerise "KLOMER" sh.p.k eshte z.Pajtim Merkaj qe zoteron 100% kapitalin themeltar.

## PER KETO ARESYE:

Ne baze te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe atij Nr.7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregetar"

## VENDOSA:

Pranimin e kerkeses.
Depozitimin ne rregjistrin tregetar te vendimit te te Asamblese se Jashtezakonshme te Shoqerise "KLOMER" sh.p.k, nr.ska, date 21.04.2005, ne te cilin eshte vendosur per:

4. Te miratoje kalimin e te drejtes se pronesise te pjeseve te kapitalit themeltar, te ortakeve, z. Neshet Zemlaku i cili zoteronte 30 % te kapitalit themeltar dhe z. Lamçe Begaj qe zoterontre 30 % te kapitalit themeltar, ne zoterim te ortakut z.Pajtim Merkaj.
5. Te miratoje largimin nga shoqeria te ortakeve Neshet Zemlaku dhe Lamçe Begaj.
6. Ortaku i vetem i shoqerise "KLOMER" sh.p.k eshte z.Pajtim Merkaj qe zoteron 100% kapitalin themeltar.

Te behen shenimet perkatese ne rregjistrin tregetar ne kollonen________
Ndaj vendimit lejohet ankim.

GJYQTARE

# A K T E  T H E M E L I M I

i shoqeris me përgjegjesi te kufizuar

"Klomer"

V I T I  N J E M I J E  E  N E N T E Q I N D E  E

N E N T E D H J E T E  E  P E S E

I P A R I Formuesit do te themelojne nje shoqeri me përgjegjesi te kufizuar te cilen do ta emertojne sh.p.k."Klomer"

I DYTI Shoqeria ka nje kapital social prej 100.000. i ndare ndermjet ortakeve Pajtim Perko 40 %, Neshet Zemlaku 30% dhe Lamce Begaj 30 % ,kapital i cili do te jete baze edhe për ndarjen e fitimit ne raportet e mesipërme,pra Pajtim Merko do te marri 40 % te fitimit,Neshet Zemlaku 30 % te fitimit dhe Lamce Bega 30 % te fitimit

I TRETI

Shoqeria do te kete nje kohzgjatje pa afat dhe mbi 10 vjet.

I KATERTI Shoqeria ka si adminisratore te saj z.Pajtim Merko

I PESTI Selia e shoqeris eshte ne Pluk-Lushnje.

I GJASHTI Shoqeria so te rregullohet pervec ketij akti themelimi dhe me norma te percaktuara ne statut.

I SHATI Objekti i veprimtaris se shoqeris regullohet me akte te vecante.

H T E M E L U E S I T

Pajtim Merko  Lamce Bega  Neshet Zemlaku

REPUBLIKA SHQIPËRIS

NOTERIA LUSHNJE

NR I AKTIT 476 nr i kol 311

V E R T E T I M

Sot me dt. 16/02/1995. para meje noter Adrian Karoqe u paraqiten Pajtim Merko biri i Nazif banues ne Lushnje,Lamce Begaj biri i Shabin banues ne Lushnje,Neshet Zemlaku biri i Shaqir

# STATUTI

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUER "KLOMER"

FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA.

Neni 1

Shoqeria private "KLOMER" formohet nga themeluesit : Pajtim Merko,Neshet Zemlaku,Lamce Bega; .

Neni 2

Shoqeria ështe person juridik dhe ështe krijuar ne përputhje me legjislacionin shqiptar dhe si e tille e fillon aktivitetin ne rregjistrimin e saj ne rregjistrin tregtar.

Neni 3

Selia e shoqerise eshte ne Lushnje Pluk. Shoqeria mund te ndryshoje selinë e saj ne zgjerimin e aktivitetit me miratimin e ortakeve.

Neni 4

Shoqeria e ushtron aktivitetin ne perputhje me legjislacionin shqipetar dhe me statusin e saj, ne teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte tij.

Shoqeria mund te krijoj filiale ne vende te tjera ne perputhje me legjislacionin përkates te atij vendi.

Neni 5

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuer i përballon humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kapitalit të investuar ne te.

LIBRI I SHOQERISE :

Neni 6

Për te preçizuar dhe për te lehtesuar veprimtarine e vet ekonomik dhe marrdheniet e punes, shoqeria do te mbajne librin e vet i cili do te quhet libri i shoqerise.

KOMPETENCA [illegible]

Neni 7

Ortaket dhe personat e pranuar ne shoqeri bien dakort që të mos i shpoqojne asnje personi te jashtem, informacionet që do te dispo-noje shoqeria, kontratat që ajo do te lidhe, si dhe planet dhe qëllimet që ajo ka për te ardhmen e saj.

Neni 8

Te gjitha aktet dhe dokumentat e tjere që do te nxirren nga shoqeria, te destinuara për te tretet, si letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme, duhet te tregojne lexueshem emrin e shoqerise dhe pas tij fjalet "shoqeri me përgjegjesi te kufizuar" ose inicialet Sh.p.k kapitalin themeltar dhe emrin e administratorit.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Neni 9

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per afat dhe mbi 10 vjet te numeruar si vitet kalendarike duke filluar nga data e rregjistrimit ne rregjistrin themeltar.

Neni 10

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj :

- projektim dhezbatim rilevime topografike
- zbatim:punime dheu,murature,betoni,b/arme zakonshme,punime shembjesh,ndertime civile,industriale,turistike bujqesore,
- kompletimi me instalimet e nevojshme,punime restaurimi,
- shtresa rrugesh,ujesjellesa,kanalizime,impiante vadites,
- punime te mbrotjes se sitemeve hidraulike,kullimi,ujitjetoke

KAPITALI THEMELTAR

Neni 11

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000. lek;

Ky kapital eshte plotesisht i nenshkruar dhe i shlyer nga ortaket.

Shoqeria mund te shtoje ose te pakesoje kapitalin e saj me mira-timin e ortakeve themelues.

Neni 12

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme e ndermjet ortakeve. Gjithashtu pjeset e kapitalit themeltar mund ti

transferohen edhe te treteve, me miratimin e ortakeve.

Gjithashtu ato jane lirisht te transferueshme ne raste ndarje pasurore mes bashkeshorteve si dhe me rruge trashegimie.

Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me nje akt noterial.

STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 13

Shoqeria do te konsideroje qendren e vet si nacen e cila rast pas rasti do te hapet edhe me filiale te tjera.

Neni 14

ORGANET E LARTE I DREJTIMIT TE SHOQERISE JANE: ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Shoqeria administrohet nga z.Pajtim Merko

---

ASAMBLEJA

Neni 15

Mbledhjet e asamblese jane te zakonshme e te jashtezakonshme.

Mbledhjet e asamblese se zakonshme duhet te thirren te pakten nje here ne vit.

Neni 16

Thirrjet e asamblese behen me letra qe permbajne rendin e dites, vendin dhe oren e mbledhjes derguar secilit ortak se paku 10 dite perpara, ose ne raste urgjente me telegram se paku 2 dite perpara.

Administratori duhet te njoftoje asamblene gjithashtu brenda 5 diteve kur behet kerkese nga ortaket ose nga njeri prej tyre qe perfaqeson se paku 10 % te kapitalit te shoqerise dhe ne keto kerkesa tregohen ceshtjet qe duhen trajtuar.

Asambleja drejtohet nga administratori i shoqerise ne qofte se ajo vendos ndryshe.

Administratori i shoqerise zgjedh nje sekretar (e) per te mbajtur procesverbalin.

Secili ortak mund te përfaqsohet me një prokure te posaçme me shkrim nga një person që nuk është ortak.

Neni 17

Asambleja merr keto vendime si e zakonshme : (kompetencat)

- Miraton statutin dhe rregulloren e brendeshme te shoqerise.

- Zgjedh administratorin e shoqerise.

- Vendos dhe analizon veprimtarine ekonomike dhe financiare te shoqerise.

- Bënë pranimin e anëtareve te rinj te shoqerise.

Neni 18

Asambleja merr vendime si e jashtezakonshme :

- Për ndryshimin e statutit të shoqerise dhe aktit te krijimit

- për emërimin e personave të ngarkuar për likujdimin.

Neni 19

Asambleja e zakonshme dhe e jashtezakonshme krijohet në rastin e pare të takimit me prezencen e dy ortakeve, te cilet vendosin në mënyrë të vlefshme me vote pro me aq ortake sa te përfaqsohet shumica ab/solte e kapitalit shoqerore.

LIBRA E SHOQERISE, BILANCI, SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI

Neni 20

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje përveç dokumentacionit kontabel ose librave te tjere edhe keto libra :

- Librin e ortakeve, ne te cilin shenohet emri i plote i tij dhe kuota e kapitalit themeltar.

- Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te organit vendimor.

- Libri i mbledhjeve dhe vendimeve të organit administrativ.

ADMINISTRIMI

Neni 21

Administratori ka kompetenca te plota për te vepruar në mardhenie me të tretet ne emër të shoqerise në të gjitha rrethanat.

Administratori ka të drejtë të marrë pjesë ,ë shitblerje, proçedu

re falimentimi, të tjetersoje pasuri të tundeshme e të patundeshme, të hape llogari rrjedhese prane bankave shqiptare e të huaja, të përfaqsoje shoqerine në organet gjyqësore e administrative.

I pajisur me prokure të posaçme nga asambleja, administratori mund te kaperceje e të veproje edhe për tej kufizimi të sipërpërmendur në kete nen.

Administratori merr te gjitha vendimet që janë në interes të punës dhe të prodhimit për probleme të emergjencës.

Raportojën dhe përgjigjet para asamblesë për drejtimin e shoqerise

Vendos për marrjen në punë dhe largimin apo pushimin nga puna të personave që ai ka nën vartesi administrative.

Administratori është unik. Ai mund të jete njëri nga ortaket, ose një person tjeter.

Neni 22

Administratori zgjidhet nga asambleja e ortakeve për një afat 2 vjeçar. Me mirkuptimin e ortakeve ai mund të qëndroje si i tille edhe për tej ketij afati, me kusht shqyrtimin formal të kandidatures së tij menjehere pas mbarimit të mandatit 2 vjeçar. Kandidatura nuk është e përsëriteshme kur të pakten 40 % e kapitalit themeltar e përfaqsuar nga një a më shumë ortake nuk e mbështesin atë.

Administratori pushon veprimtarine e vet kur :

- Jep dorheqje
- Përfundon afati
- Shkel rëndë e në mënyrë të përsëritur statutin, aktin e krijimit aktmarrveshjen e ligjet e shtetit shqiptar.

ANËTARËSIA ( Të qënit ortake )

Neni 23

Anëtar i shoqerisë quhet ai person i cili merr pjesë direkt ne kapitalin themelor të shoqerise me të drejtën e tij të pronësisë mbi pjesë të tij të njohur ligjerisht me akte ligjore, konforme legjislacionit shqiptar.

Anëtarsia në përgjithësi është e drejtë vetiake.

Kuotat e anëtarit mund të transferohen me akte ndërmjet të gjallëve nga ortaku tek bashkëshorti dhe farefisi. Ato mund tu tran sferohen edhe të tjereve. Gjithmone ne keto raste kerkohet mirtsimi i Asamblese se ortakeve.

Anëtari i shoqerise nuk mund te jete si i tillë në më shumë se një shoqëri me kete objekt veprimtarie.

Neni 24

Të drejtat e anëtareve humbasin kur :

- Anëtari largohet nga shoqeria me deshiren e vet.
- Përveteson në çfardo shume pasurine e pë bashket të shoqerise.
- Zhvillon aktivitet të jashtem ekonomik që bie ndesh dhe demton rëndë interesat e shoqerise apo i krijon asaj përfitim personal situata renduese konkuruese.

Neni 25

Çdo anëtar ka të drejtë :

- Të zgjedhe e të zgjidhet në organet e shoqerise.
- Të ma rë pjesë në veprimtarinë prodhuese e shoqërore të SHPK
- Të gëzojë të ardhura (fitimin) që rrjedh nga aktiviteti i shoqërisë.

BILANCI

Neni 26

Bilanci mbyllet më 31 dhjetor të çdo viti. I pari do të jetë ai i vitit 1995 .

Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel, i autorizuar nga ortaket, miratohen nga ata. Miratimi i ketyre dokumentave mbi veprimtarine vjetore bëhet brenda një afati prej kater muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

DEVIDENTET

Neni 27

Pas mirtsimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzisten cës së fitimeve, përcaktohet pjesa që i takon ortakeve themelues në

LUSHNJE

formin e devidentit mbi fitimin.

Ky fitim përbëhet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për fondin rezervë të domosdoshëm të përcaktuar nga vete ortaket, të fondeve të tjera që shihen të nevojshme dhe nga ana tjetër janë zbritur ose janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e më parshme.

SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 28

Shoqëria prishet kur ka një prishje të parakohëshme të parashikuar në ligj.

Neni 29

Shoqëria hyn në proçesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e ketij proçesi ortaket caktojnë një apo disa likujdues të cilët i paraqesin asamblesë raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimit dhe mbi afatet e nevojshme të përfundimit të tyre. Në fund të proçesit të Likujdimit ortaket vendosin mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e proçesit të likujdimit. Pas pagimit të kreditoreve dhe shlyerjes se kapitalit themeltar kontribues ( në se ka të tillë) likujduesi ndan kapitalet për të dy ortaket themelues.

MARDHENIET PËR PUNËSIM

Neni 30

Kriteret e përgjithëshme të punësimit të personave të tjere, numrin e tyre, kufijte e pagesës dhe detyrat e secilit në shoqëri, përcaktohen nga ortaket.

Punësimi i personave në shoqëri kryhet mbi bazen e kontrates individuale të punës, të hartuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 31

Shoqeria merr përsipër të respektoje rregullat në fuqi të punësimit dhe të sigurimeve shoqërore për të gjithë të punësuarit, ndërsa këta të fundit duhet të pranojnë këtë statut.

Të punësuarit përgjigjen sipas ligjit dhe sipas ketij statuti për mos zbatimin e detyrave dhe për demet që ata i shkaktojnë shoqërisë.

## Neni 32

Të gjitha mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhes së likujdimit; që mund të lindin midis shoqërisë dhe të treteve, do të tentohet të zgjidhen me mirkuptim, në të kundert do ti paraqiten për zgjidhje gjykates kompetente shqiptare konforme legjislacionit shqiptar.

DISPOZITA TË FUNDIT

## Neni 33

Shtimi i ortakeve

Kur ortaket janë dakort që të bëhen shtesa kapitali me anë të personave të tjere, që këta të konsiderohen ortake, duhet të veprohet keshtu :

- Së pari : merret vendim nga ortaket themelues, ku shqyrtoh kerkesa e të interesuarit, bëhet pranimi dhe përcaktohet kuota e kapitalit që do të derdhe ortaku i ardhshem.
- Së dyti : bëhet rregjistrimi në librin e ortakut, ku shkruhet emri i plotë i ortakut të ri dhe kuota në kapitalin e shoqërisë.
- Veprimi i bashkimit me ortakun e ri duhet të bëhet me akt noterial.

## Neni 34

Për sa nuk është shprehur në këtë statut i referohet plotësimit të mëtejshëm me anë amendamentesh sa here që e shohin të arsyeshme ortaket themelues të kësaj shoqerie.

Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti bëhen në të njëjtën mënyrë dhe procedurë me të cilën bëhet vete nxjerrja e ketij statuti.

Ndryshimet nuk prekin personalitetin juridik të shoqërisë.

Ky statut është hartuar në katër kopje shqip e pasi lexohet e gjehet në përputhje me vullnetin e palëve nënshkruhet prej tyre rregullisht.

O R T A K E T

Pajtim Merko | Lemce Begaj | Neshet Zemlaku

25 PRILL 2005

# KERKESE

**KERKUESI: Pajtim Merkaj , i biri** zotesi te plote juridike per te vepruar me cilesine e Administratorit te Shoqerise "KLOMER" shpk.
**OBJEKTI** :Depozitimin e Vendimit nr.1 date 21.04.2005 te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "KLOMER" shpk , ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite Tregtare"

**PERPARA**
**GJYKATES SE SHKALLES SE PARE**
**TIRANE**

Shoqeria "KLOMER " sh.p.k regjistruar si person juriudik me Vendimin nr.8958 date 16.02.1995 ne Regjistirn tregtar te Gjykates se shkalles se Pare Tirane .
Me vendim Nr.1 date 21.04.2005 te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "KLOMER" shpk eshte vendosur shitja e kuotave te kapitalit fillestar te ortakve te shoqerise z.Neshet Zemlaku dhe Lamce Bega ne pjeset e tyre takuese dhe largimi i tyre nga shoqeria .
Ortak i vetem i shoqerise mbete z. Pajtim Merkaj me 100% te kuotave te kapitalit ne shoqerine "KLOMER" shpk.
Persa me siper duke ju bashkangjitur dhe dokumentacionin perkates ,kerkoj pranimin e kerkeses ne baze te ligjit

KERKUESI

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTEREVE TIRANE**
**Nr 1645 Rep. Nr — Kol.**

## VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 23.04.2005 (dymije e pese ) para meje noteres Rajmonda DYRMISHI me seli ne Rrugen " M. Shyri " ,pll.49 ne Tirane u paraqite personalisht **Pajtim Merkaj** , me zotesi te plote juridike per te vepruar me cilesine e Administratorit te Shoqerise "KLOMER"shpk,identifikuar me pasaporte nr .1440026.
I Paraqituri me siper me cilesine e administratorit te Shoqerise "KLOMER "sh.p.k nenshkruan para meje noteres kerkesen per depozitim te vendimit te Asamblese se Ortakeve te hartuar jashte kesaj zyre.
Une noteria vertetoj nenshkrimit e tij ne baze te ligjit.

NOTERE

PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE

SHOQERIA “KLOMER ” SH.P.K

VENDIM NR.1
I ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Sot me date 21.04.2005 ne Tirane u mblodh Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve te Shoqerise “KLOMER ” shpk me pranine e z.Pajtim Merkaj qe zoteron 40% te kuotave ,Z.Neshat Zemlaku qe zoteron 30% te kuotave dhe Z.Lamce Begaj qe zoteron 30% te kuotave te kapitalit ne kete shoqeri ne mbeshtetje dhe dizpozitave te Statutit te shoqerise e cila mori ne shqyrtim ceshtjen si me poshte:

1. Shitjen e pjeseve te kuotave qe zoteron z.Neshat Zemlaku ne masen 30% ne kete shoqeri dhe Z. Lamce Begaj qe zoteron ne masen 30% te kuotave ne kete shoqeri ne favor te z.Pajtim Markaj .
2. Largimin e tyre nga Shoqeria “ KLOMER“ shpk.

**K O N S T A T O I**

-Se Asambleja e Ortakeve te Shoqerise “KLOMER ”sh.p.k aktualisht perbehet nga 3-ortake z.Pajtim Merkaj qe zoteron 40% te kuotave ,Z. Neshat Zemlaku qe zoteron 30% te kuotave dhe Z. Lamce Begaj qe zoteron 30% te kuotave te kapitalit ne kete shoqeri .

Ortaket e shoqerise z.Neshat Zemlaku dhe Lamce Begaj qe zoterojne 30% sejcili te kuotave te kapitalit ne kete shoqeri deshirojn dhe bien dakort qe kuotat e kapitalit gjithesej 60% qe zoterojne se bashku tja shesin z. Pajtim Merkaj i cili eshte administratori i shoqerise

Largimin e tyre nga shoqeria “KLOMER”shpk.

**PER KETO ARSYE**

Konform vullneti te lire e te pavarur te Ortakeve pjesmarres Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve ne unanimitet:

**VENDOSI :**

1.Shitjen e pjeseve prej 30% sejcili te kuotave te z.Neshat Zemlaku dhe Lamce Begaj ne favor te z.Pajtim Merkaj dhe largimin e tyre nga Shoqeria “ KLOMER” shpk.

2. Te depozitohet Vendimi nr.1 date 21.04.2005 i Asamblese se Ortakeve te Shoqerise “KLOMER ” shpk te depozitohet ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Shkallles se pare Tirane dhe Kontrata e shitjes se Kuotave dhe te behen ndryshimet perkatese .

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Lamce Begaj Neshat Zemlaku Pajtim Merkaj

K E R K E S Ë

KERKUES Pajtim Merko biri i Nazif banues ... Lje"Gafurr Muco" Nr 187,dtl 1952.

Neshte Zemlaku biri i Shaqir banues ne Lushnje dtl 1944,

Lamce Begaj biri i Shahin banues ne Lushnje Moni Dhama Nr 14.

Të megjistrohet
dt. 16-2-95

ME O B J E K T E Regjistrimin si person juridike te shoqeris me përgjegjesi te kufizuar"Klomer" ne baze te ligjit 7667 dt.28.01.93.

P Ë R P A R A _ G J Y K A T E S _ _ R R E T H I T _ T I R A N E _

Ne te nenshkruarit Pajtim Merko,Neshet Zemlaku,Lamce Begaj kerkojme te regjistrojme si person juridike sh.p.k."Klomer".

Shoqeria tregtare "Klomer" e ka seline ne Pluk Lushnje, me ortake Lamce Begaj,Pajtim Merko,Neshet Zemlaku,me adminisratore z.Pajtim Perko,me kapital fillestare 100.000. lek,me kohzgjatje pa afat dhe mbi 10 vjet,me objekte veprimtarie projektim dhe zbatim:rilevime topografike;zbatim:punime dheu,murature,betoni, b/arme te zakonshme;punime shembjesh,ndertime civile,industriale, turistike,bujqesore,dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to,punime restaurimi,punime te shtresave te ~~xxxxxxx~~ rrugeve, ujesjellesa,kanalizime,impiante vadites,punime te mbrotjes se sistemeve hidraulike,kullimi,ujitje e tokave .

K E R K U E S I T

P a j t i m Merko Neshet Zemlaku Lamce Begaj

REPUBLIKA SHQIPËRIS
NOTERIA LUSHNJE
Nr i aktit 476

V E R T E T I M

Sot me dt. 16/02/1995. para meje noter Adrian Karoqe u paraqiten Pajtim Merko biri i Nazif, Neshet Zemlaku biri i Shaqir banues ne Lushnje,Lamce Begaj banues ne Lushnje madhore me zotesi juridike për indetitetin e te cileve u njoha ne baze te

/ //

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTETREVE TIRANE**
**NR** 1644 **REP.**
**NR** 96 **KOL.**

## KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH TE KAPITALIT TE SHOQERISE "KLOMER"

Sot me date 23.04.2005(dymije e pese)ne Tirane para meje noteres Rajmonda Dyrmishi ,me seli ne Rrugen"M. Shyri",pll.49 u paraqiten personalisht per nje kontrate shitblerje kuotash ne baze te nenit 705 e vijues te K. Civil dhe Ligjit Tregtar , palet :

**PALA SHITESE :**

**1.Neshat Shaqir Zemlaku,**lindur me 1943 ne Lushnje ,banues ne Tirane,Rr. " Bajram Curri", nr.14madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar ,identifikuar me pasaporte. 01115964.

**2.Lamçe Shahin Begaj,**lindur me 10.12.1953 ne juridike per te vepruar, identifikuar me pasaporte nr.Z0038907.

**PALA BLERESE :**

**1.Pajtim Nazif Merkaj,** lindur ne Lushnje ,banues ne Tirane , madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar,identifikuar me pashaporte nr. 1440026.

Ne mbeshtetje te Vendimit Nr.8958 date 16.02.1995 te Gjykates se rrethit Tirane ,akt themelimit dhe statutit te Shoqerise "KLOMER"shpk Z. Neshat Zemlaku zoteron 30% te kuotave , Lamçe Begaj zoterone 30 % (tridhjete perqind) te kuotave dhe z,Pajtim Merkaj 40% te kuotave ne Kapitalin Themeltar ne shoqerine "KLOMER" sh.p.k.Pala shitese Neshat Zemlaku dhe Lamce Begaj ne mbeshtetje dhe Vendimit nr.1 date 21.04.2005 te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "KLOMER" shpk bie dakort qe te shesin sejcili kuotat e tyre te kapitalit qe zoterojne ne kete shoqeri , ne masen 60% gjithesej te kuotave me cmimin ne vleften totale 60000(gjashtedhjetemije)leke, ne favor te pales blerese Pajtim Merkaj ,duke u larguar dhe nga veprimtaria dhe cdo detyrim i shoqerise.

Pala shitese garanton palen blerese se shitja e kuotave te kapitalit te shoqerise behet pa asnje kusht apo barre per palen blerese duke u likujduar per detyrimet reciproke jashte kesaj zyre dhe pala blerese Pajtim Merkaj pranon te bleje kuotat e kapitalit ne pjeset e percaktuara me larte dhe cmimin e shitjes .

Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe noterizimin e saj pala shitese zhvishet nga pronesia mbi pjeset e kuotave te kapitalit qe zoterojne dhe pala blerese behet zoteruese 100% te kuotave te kapitalit te Shoqerise "KLOMER" shpk .Persa nuk eshte shprehur ne kete kontrate i referohet rregullimit nepermjet dizpozitave te K.Civil ne fuqi,Ligjit nr.7638 date 19.11.1992"Per Shoqerite tregtare' dhe Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar".

Gjate perpilimit te kesaj kontrate u administruan aktet perkatese te shoqerise, vendimi e Gjykates se Shkalles se pare Tirane per shoqerine .

Kontrata u hartua ne perputhje me vullnetin e lire te paleve ne njohur prej paleve dhe nga une notaria te cilet pasi e lexuan , nuk kane verejtje dhe nenshkruajne rregullisht para meje noteres.

Une noteria e vertetoj aktin ne baze te ligjit.

PALET

SHITESIT

1

2

BLERESI

1

NOTERE

